

# ***Reforma e Pensionit në Europën Qëndrore dhe Lindore:*** **Një përmbledhje mbi ristrukturimin e skemave kombëtare të pensionit** **në vendet e zgjedhura**

**Elaine Fultz dhe Markus Ruck**

## ***Përmbledhje:***

Ky dokument ju jep një përmbledhje mbi zhvillimin e iniciativave në rrugë e sipër në vendet e zgjedhura të Europës Qëndrore dhe Lindore në ristrukturimin e skemave kombëtare të pensionit. Burimi kryesor i tyre për informacion është procedura nga konferenca rajonale e pensioneve e mbajtur në Pragë në Prill 2000, e financuar nga bashkëpunimi i Ministrisë Çeke të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Kjo Konferencë u organizua për të shtytur një shkëmbim të të dhënave dhe ideve midis ekspertëve për pension nga nëntë shtete: Kroacia, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Sllovaqe, Sllovenia si dhe Republika Çeke. Pranvera e vitit 2000 ishte një kohë e favorshme për një shkëmbim të tillë pasi vendet e EQL kishin ndërmarrë perqasje të ndryshme në ristrukturimin e pensioneve dhe po procedojnë në hapa të ndryshme, një situatë e cila i lejon ata në stadin fillestar të përfitojnë nga eksperiencia e të tjerëve që kanë lëvizur përpara në drejtime të caktuara. Nga kjo perspektive, ngjarjet më të fundit në Hungari dhe Poloni ishin me një interes të lartë për pjesëmarrësit e konferencës, pasi që të dyja vendet ndodhen tani në procesin e të ashtuquajturit implementim të reformës radikale e cila zëvendëson pjesërisht skemat publike të pensionit me sisteme mandati të llogarive kursimi individuale të drejtuara komercialisht. Duke reflektuar këtë interes, dokumenti përqëndrohet më së shumti në eksperiencat e këtyre vendeve.

Analiza ka tre pjesë. Pjesa e parë siguron një fushë, duke portretizuar skemat e pensioneve që ishin trashëguar nga qeveritë e EQL nga koha socialiste, impaktin e tranzicionit në përfitim të tyre dhe financimit, dhe rolin të pritur të ndryshimeve demografike në shpenzimet e skemave në dekadat e ardhshme. Pjesa e dytë përshkruan reformat e ndërmarrë përmes rajonit gjatë viteve '90. Këto janë diskutuar në dy kategori të gjera, ristrukturimi i skemave publike dhe privatizimi, dhe një parashtrim i modeleve të para ishte identifikuar. Pjesa e tretë ofron përfundimet dhe sygjeron masa të cilat mund të forcojnë reformën e marrë. Meqë reforma e pensionit është nga natyra e saj një ndërmarrje me afat të gjatë, përfundimet janë formuluar sa për provë, me një njohje që forcat të cilat nuk janë ende të dukshme të mund të përcaktojnë rezultatet përfundimtare. Këtu paraqiten veshtrimet e autorit dhe jo domosdoshmërisht të pjesëmarrësve të konferencës, dhe ato nuk janë qëndrim zyrtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Në përgjithësi, analizat tregojnë që:

- Shpenzimet tranzicionale të lëvizjes nga mënyra “pagim sapo largohesh” në financimin të paraprak të pensioneve janë më të larta se ato të projektuara në Hungari dhe Poloni, kjo e shkaktuar së pari nga numri më i madh i punëtorëve që priteshin të zgjidhnin pensione private. Në shkallë të 0.5-1.2 për qind të GDP për vit, këto shpenzime tranzicionale shtrojnë një ngarkesë të rëndë financiare. Në Hungari, niveli i tyre më i lartë se pritej, ishte një faktor në tërheqjen e qeverisë në një planifikim të rritur në pjesën e të ardhurave të skemës të caktuara për rradhën e re të privatizimit, një veprim i cili mund të shprehë garanci legale të niveleve të përfitimeve private në vitet e ardhshme, duke rritur më tej shpenzimet e reformës.
- Ambjentet politike dhe ekonomike në të cilat është zbatuar reforma e pensionit janë të paqëndrueshme në shumicën e vendeve të EQL, për shkak të tregjeve financiar të vegjël dhe të sapo formuar dhe ndryshimeve të herëpashërshme në qeveri. E mëparshnja po udhëheq drejtuesit e pensioneve private të investojë nivele të larta të kursimeve të punëtorëve në publik, si kundërshtim i privatizimit, sigurisë, ndërsa e vonshnja po udhëheq drejt përsëriteve gjysmë- kursi në politikat e reformës. Mungesa e vazhdimësisë është më shumë problematike në lidhje me reformat radikale të cilat duhet të vendosen në vend në një periudhë vitesh.
- Çështjet kyçe të lidhura me strukturën e përfitimeve të pagesave të privatizimit janë akoma të pazgjidhura në të dyja vendet, Hungari dhe Poloni. Këto pasigurira i lanë punëtorët e tanishëm në të dyja vendet pa njohurinë e duhur për të bërë një zgjedhje të informuar që ose ti bashkangjiteshin një skeme të re shtesë private ose jo. Ata gjithashtu e bënë të vështirë të vlerësojnë reformat në kufi të kritereve kryesore të siguracionit në pension.
- Llojshmëria e masave të reformave e zhvilluar përgjatë rajonit është përherë e më e ndryshme. Ndërsa shumë shtete po planifikojnë reforma radikale në të njëjtën vijë me Hungarinë dhe Poloninë, të tjerat si Republika Çeke, Estonia dhe Sllovenia po restrukturojnë skemat e tyre publike “pagim sapo largohesh” pa i ndertuar shtyllat e mandatit privat. Konsiderimi kryesor për këto qeveri të cilat kanë marrë përqasjen me te vonshme të ngarkesës financiare të shpenzimeve të larta të tranzicionit.
- Dialogu social mbi reformën e pensionit është kufizuar në shumicën e vendeve të EQL, dhe miratimi trepalësh nuk është arritur shpesh. Kjo është si shkak i mungesës së traditës të këtyre lloj dialogjeve, në disa humbje të qeverive për të zbuluar nevojën për të, dhe të kufizojnë eksperiencën në anë të punëtorëve dhe të punësuarve në përbushjen e roleve të tyre. Shkalla e miratimit e arritur në Poloni qëndron në demonstrimin që mbështetja nga partnerët socialë mund të ndihmojë për të siguruar stabilitet për legjislacionin e reformës, duke e mbajtur në drejtim panvarësisht nga ndryshmet në qeveri.

## I. Përmbajtja për reformën:

Mundësitë për hapje të reformës të pensionit në vendet e EQL janë modeluar nga karakteristikat e sistemeve të pensionit që ato kanë trashëguar, nga impakti i ndryshimeve politike dhe ekonomike mbi këto sisteme gjatë viteve të mëparshme të tranzicionit, dhe ndikimit të ngjashëm të zhvillimeve demografike në vitet e ardhshme. Ky seksion jep një përmbajtje për analiza të reformave të ndërmarra duke i egzaminuar këto faktorë.

### A. Skemat e pensionit para tranzicionit

Një nga trashëgimitë e kohës socialiste në vendet e EQL ishte roli i madh i shtetit në sigurimin e të ardhurave: pensionet ishin një përgjegjësi e madhe e qeverisë dhe nuk gjendeshin pothuajse asnjë lloj marrveshesh private. Pensionet financoheshin në bazë të mënyrës "pagim sapo largohesh" nëmjet transferimeve të fondeve nga firmat pronë shtetërore për në buxhetin e siguracionit shoqëror përbrenda buxhetit të shtetit.<sup>1</sup> Kontribut i drejtëpërdrejt nga punëtorët ishte i rrallë dhe, kur kërkohej, ishte vetëm simbolik. Të ardhurat për kontigjente të ndryshme (moshat e vjetra, të paafët, të mbijetuarit.) financoheshin nga i njëjti buxhet ose bashkim burimesh. Transparenca ishte e paktë në mbledhjen dhe lokalizimin e burimeve.

Mosha e daljes në pension në vendet e EQL ishte paksa më e ulët se ajo në vendet e OECD, sikurse tregohet në Tabelën 1. Në shumë vende të EQL, punonjësit meshkuj mund të dilnin në pension në moshën 60 vjeç me 25 vjet shërbim, ndërsa gratë shpesh dilnin në moshën 55 ose, në disa shtete në një moshë që varej dhe nga numri i fëmijëve të rritur.<sup>2</sup> Gjendeshin gjithashtu dhe shumë rrugë për dalje të hershme në pension, dhe shumë pensionista shpesh vazhdonin të punonin ndonëse e merrnin përfitim.

**Tabela 1. Mosha mesatare e daljes në pension, 1950 dhe 1990**

	1950	1990
<b>Shtetet e OECD</b>		
<b>Meshkuj</b> .....	<b>68.5</b>	<b>62.2</b>
<b>Femra</b> ... ..	<b>66.0</b>	<b>60.0</b>
<b>Shtetet e EQL</b>		
<b>Meshkuj</b> .....	<b>67.6</b>	<b>60.9</b>
<b>Femra</b> .....	<b>62.5</b>	<b>57.6</b>

Burimi: Latulippe, D., "Mosha efektive e daljes në pension dhe gjatësia e pensionit në vendet e Industrializuara ndërmjet vitit 1950 e 1990. *Çështje të Mbrojtjes Sociale*, Zyra Ndërkombëtare e Punës, Dokument Diskutimi No. 2 (Geneva) 1996.

Në përgjithësi, skemat e para-reformave ishin hartuar për të rishpërndarë të ardhurat, dhe lidhja midis kontributeve dhe përfitimëve ishte e dobët. Përfitimet ishin llogaritur bashkërisht si një përqindje e fiksuar nga të ardhurat e referuara të punëtorëve për një numër minimum vitesh, shpesh me një komponent të përqindjes-së ulët dhe/ose një përfitim maksimal. Këto të dhëna prodhuan një strukturë relativisht me përfitim të ulët. Megjithatë, gjendeshin shumë të ashtuquajtura privilegje, p.sh. moshat e reja të daljes në pension dhe shumata e mëdha të përfitimit për punë të favorizuara nga shteti. Në shumë shtete, privilegjet nuk ishin shtrirë vetëm tek punëtorët në rrezik dhe në vendet strategjike, por gjithashtu në sektorë të tjerë të industrisë (p.sh., tek drejtuesit dhe administrata e minierave por edhe tek punëtorët që punonin nëntokë), por ishin financuar nga kontributet e paguara në emër të të gjithë punonjësve, duke rezultuar në rishpërndarje të pavolitshme. Përshtatjet e përfitimit nuk ishin në përgjithësi të mjaftueshme për të kontrolluar inflacionin ose rritjet emërore të pagës, që të çonin në shformimin midis pensionistëve të vjetër dhe të rinj. Sa më gjatë një pensionist e zgjidhte pensionin, më shumë e pamjaftueshme bëhej në lidhje me koston e jetesës së tanishme.

Në fillim të tranzicionit, përpjestimet e sistemit varës ishin në shkallë të 30-45 pensionistë për cdo 100 punëtorë, megjithëse kishte variacione të gjera nga një shtet në tjetrin (p.sh., 27 pensionista për 100 punëtorë në Shqipëri, 62 në Ukrainë).<sup>3</sup> Ndërsa këto shkallë ishin të larta krahasuar me ato të vendeve të tjera të botës, përhapja e pensionit si përqindje për GDP ishte relativisht e ulët, duke shkuar në 5.6 % për shtetet Balltike dhe 7.6 % për shtetet e CEFTA-s në 1989.<sup>4</sup> Kjo

<sup>1</sup> Sikurse skemat e pensioneve në Europën Perëndimore, këto skema ishin të financuara plotësisht që nga fillimi; por rezervat e tyre u shpërbënë gjatë Luftës së II Botërore, duke udhëhequr drejt financimit të mënyrës "pagim sapo largohesh" në periudhën e pas luftës. Muller, Katharina, "10 Vite më Pas: Reformat e Pensionit në Vendet e EQL dhe Ish Vendet e Bashkimit Sovjetik" Instituti i Frankfurtit për Studime Ndërkombëtare, Shkurt 2000.

<sup>2</sup> Hagemeyer, Krzysztof, "Transformimi i Siguracionit Social në Europën Qendrore dhe Lindore", në Katharina Muller, Andreas Ryll, dhe Hans-Jurgen Wagener, eds., *Transformimi i Siguracionit Social: Pensionet në Europën Qendrore dhe Lindore* (Heidelberg: Physica-Verlag, 1999), fq. 49.

<sup>3</sup> Palacios, R., M. Rutkowski, dhe X. Yu, *Reformat e Pensionit në Ekonominë e Tranzicionit*, (Washington, D.C.: Banka Botërore, 1999), fq. 105.


<sup>4</sup> Përqindja në 1990 e punëtorëve të dalë në pension ishte 24 % në U.K., 21 % në Francë, 22 % në Gjermani, 18 % në US, dhe 17 % në Japoni. Shtetet e CEFTA janë ato që nënshkruan Marrëveshjen e Tregut të Lirë në Europën Qendrore, por ato që i referohen këtu janë Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia (në 1997, Rumania u bë anëtare gjithashtu). Hagemeyer në Muller (1999), fq. 51.

mund të jetë pjesërisht nga ndarja e ulët e pagave në GDP, të cilat në 30-40 % ishte gjithashtu më poshtë së në shumicën e shteteve të Europës Perëndimore.<sup>5</sup>

## B. Ndikimi i tranzicionit

Në shumicën e shteteve, tranzicioni solli një turrje të menjëhershme në prodhim dhe punësim, me nivelet e prodhimit që zvogëloheshin nga 20-50 % nën nivelet e 1989.<sup>6</sup> Janë gjendur variacione të gjera në normën e përmirësimit. Shiko Figurën 1. Shtetet e CEFTA-s përgjithësisht e rifilluan rritjen në 1993 dhe rishtuan nivelet e prodhimit të tyre para-tranzicional në 1997.<sup>7</sup> Ato u ndoqën nga shtetet Balltike ku rritja në përgjithësi rifilloi në gjysmën e dytë të dekadës. Rritja në Europën Juglindore, ndërsa tani në lëvizje e sipër, ka qënë më pak vendimtare.

**Figura 1. GDP e vërtetë në vitin 1999 (e projektuar) në përqindje me vitin 1989**  
1989 = 100



Burimi: Konsensusi i Phare-it, *Ndryshimi dhe Zgjedhja në Mbrojtjen Sociale: Eksperiencia e Europës Qëndrore dhe Lindore* (Pantheron, Universiteti i York-ut, 1999), fq. 51.

Punësimi u zvogëlua dukshëm, sic tregohet në Tabelën 2. Në 1995, përqindja e mesatares së papunësimit ishte 12.5 % në vendet e CEFTA-s dhe Europës Juglindore.<sup>8</sup> Në shtetet e CEFTA-s, zvogëlimi i përqindjes në punësim ishte më e madhe se ajo e prodhimit (me përjashtim të Republikës Çeke), ndërsa në shtetet e tjera rënia e papunësimit ishte më e pakët, duke reflektuar papunësinë e fshehur në formë të orëve të punës së shkurtuar ose të pushimeve pa pagesë. Ndërsa shumë shtetë në tranzicion pothuajse kanë patur tani 2-6 vite të përmirësimit të prodhimit, punësimi ka vazhduar të zbrapset ose të ndërpritet. Në katër shtete -- Republika Çeke, Hungaria, Polonia dhe Republika Sllovaqe – pesë milion punë janë humbur që nga 1989.<sup>9</sup>

<sup>5</sup> Përqindja ishte rreth 52 % në Francë dhe në Gjermani dhe UK rreth 55 %. Hagemer në Muller (1999), fq. 47.

<sup>6</sup> Duhet të kihet parasysh, se baza në të cilën janë kryer krahasimet, 1989, e bën krahasimin të pasigurt sepse mungesa e të dhënave statistikore të besueshme mbi GDP dhe periudha e punësimit në para-tranzicion.

<sup>7</sup> Hagemer në Muller (1999), fq. 35.

<sup>8</sup> Hagemer në Muller (1999), fq. 35.

<sup>9</sup> Augusztnovics, Maria, "Sistemet e Pensionit dhe Reformat në Shtetet në Tranzicion" në *Vlerësimin Ekonomik i Europës* (Komisioni Ekonomik për Europë dhe Kombet e Bashkuara, , 1999, Vol .3), fq. 91.

**Tabela 2. Punësimi në vendet e zgjedhura në përqindje me nivelet e vitit 1989  
(1989=100)**

	1991	1993	1995	1997	1998
Shqipëria	97.5	72.7	79.0	76.9	76.6
Bosnja dhe Hercegovina	58.1	9.9	10.1	34.4	36.4
Bullgaria	81.6	73.8	75.2	72.3	71.2
Kroacia	88.5	76.5	73.9	73.4	..
Republika Çeke	93.6	89.7	92.8	92.4	90.2
Hungaria	86.8	72.1	69.3	69.1	70.3
Polonia	90.1	84.3	86.7	90.8	91.1
Rumania	98.5	91.9	86.7	82.4	..
Slovakia	85.9	80.4	80.7	81.5	81.2
Slovenia	88.7	81.3	79.1	78.6	78.7
Maqedonia	95.6	86.2	73.9	66.8	65.0
Estonia	96.4	84.5	78.3	77.4	..
Letonia	99.3	85.6	74.3	73.7	74.1
Lituania	99.7	93.4	86.4	87.7	87.0
Moldavia	99.0	80.7	80.0	78.7	77.7
Ukraina	98.3	94.1	93.3	88.8	87.7


Burimi: Komisioni Ekonomik për Europë dhe Kombet e Bashkuara, *Vlerësim Ekonomik i Europës* (1999, Nr. 3), Shtojca Tabela B.5.

Nga prespektiva ekonomike dhe sociale, kjo humbje e punësimit ka ndikime të shumëfishta: krijoi vështirësi të shumta për punonjësit e prekur ndërsa në të njëjtën kohë zvogëloi papunësinë e fshehur dhe kontribuojë në një rritje të prodhshmërisë së punës. Për skemat e pensioneve, megjithatë, impakti ishte njëtrajtshëm negativ: kontributet ranë dhe pagesat e përfitimeve u rritën, duke krijuar një të çarë të gjerë financiare. Numri i skemave të kontributorëve u ul nga 30 % në Bulgari, 45 % në Letonia dhe mbi 60 % në Shqipëri, ndërsa më pak humbje pësoi Republika Çeke, 7-8 % dhe Republika Sllovaqe 5%.<sup>10</sup> Shiko Figurën 2. Përveç kësaj, shumë firma humbën të bënin kontribute të rregullta në emër të punëtorëve që mbajtën për shkak të vështirësive financiare, duke i drejtuar në akumulime të mëdha të prapambetura. Ata punonjës të shpërngulur, të cilët gjetën punësim në rajonin jozyrtar të zgjeruar, përgjithësisht ngelën larg afërimit të siguracionit social të agjencive kolektive, duke rezultuar në humbje nga mbulimi i skemave të ardhura. Në disa shtete, këta punonjës tani arrijnë një çerek ose më shumë të forcës punonjëse kombëtare: në Lituani, numri i punonjësve të paregjistruar është 22 % dhe në Shqipëri 28%.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Pakësimi në Shqipëri u theksua nga privatizimi i bujqësisë. Këtu nivelet e ulëta të mbledhjes mund tu atribuohen pjesërisht dobësive në sistemin e mbledhjes pas privatizimit dhe pjesërisht mungesës së të ardhurave në para të gatshme midis fermerëve të vegjël furnmizues.

<sup>11</sup> Për Lituani, Konsensusi i Programit Phare, Ndryshimi dhe Zgjedhja në Mbrojtjen Shoqërore: Eksperiencia e Europës Qëndrore dhe Lindore (Pantheron: Universityeti i York-ut, 1999), p. 52. Në Shqipëri, inspektimet derë më derë të firmave ishin ndërmarrë bashkarisht nga oficerët e Institutit të Sigurimit Social dhe Ministrisë së Punës gjatë Majit dhe Qershorit të vitit 2000. Rezultatet treguan një mos-përputhje të rezultatit 28 për qind.


**Figura 2. Kontributet për vendet e zgjedhura në përqindje me nivelet  
Para - 1992**  
*Indeksi: para-1992=100*



Burimi: Palacios, R., M. Rutkowski, dhe X. Yu, Reforma e Pensionit në Ekonominë e Tranzicionit, Banka Botërore, Uashington, D.C., Qershor 1999.

Nga ana e shpenzimeve të regjistrimit të financimeve të pensionit, qeveritë sigurojnë ad hoc përfitime të rritura për të kompensuar inflacionin dhe për të kufizuar furnizimin me nevojat kryesore. Si rezultat shumë qeveri liberalizuan paaftësinë dhe ndalesat në dalje të hershme në pension për tu marrë me ngritjen e papunësisë. Ky përdorim i skemave të pensionit si një mbështetje në thithjen e fuqisë punëtore rezervë të tepërt për mirëqenien dhe skemat e papunësisë, të cilat ishin akoma duke u zhvilluar në shumë vende, megjithatë ishte konsideruar me shtrenjtë se ndalesa e drejtpërdrejtë e përfitimeve të papunësisimit dhe la një tension në financimin e skemave të pensionit që do të vazhdojë për shumë vite të tëra. Ngritjet e dukshme në përfitimet e mbingarkesës shfaqen në Rumani dhe Poloni. Shih Figurën 3.

**Figura 3. Përqindja e rritjes tek pensionistët në vendet e zgjedhura**  
(Indeksi para-1992=100)



Burimi: Palacios, R., M. Rutkowski, dhe X. Yu, Reforma e Pensionit në Ekonominë e Tranzicionit, Banka Botërore, Washington, D.C., Qershor 1999.


Ky kombinim i faktorëve shkaktoi një rritje të dukshme në përpjestimin e varur të sistemit të pensionit vetëm në pak vite. Shih Figurën 4. Shqipëria, një shtet i ri demografik, lëviz nga përpjestimi i ulët në më të lartën. Letonia dhe Rumania provuan rritje në 100 %, ndërsa Hungaria, Lituania, Polonia dhe Sllovenia pësuan 50 % ngritje. Me një rritje më të ulët se 10 % Republika Çeke bëri kontrast të dukshëm me vendet fqinje, ndonëse rënia që pësoi në vitet 1999-2000 ka mundur të ndryshojë pozitën e saj. Ukraina, gjithashtu, kishte një ngritje të vogël, ndonëse atje faktet aktuale janë më pak të sigurta kjo për shkak të praktikës së përhapur të vendosjes së punonjësve në pushim administrativ dhe të grumbullimit të madh të kontributeve të prapambetura.

Skemat e pensionit “Pagim sapo largohesh” janë përshkruar shpesh në kuptimin e zbuluar të tyre për lëvizjet demografike. Sidoqoftë, rritjet e shpejta dhe të mëdha të vërejtura këtu nuk janë shkaktuar nga ndryshimet në shkallët e lindjes apo të vdekjes, por nga ndryshimet në tregun e punës. Në lidhje me këtë Augusztinovics ka theksuar:

Mësimi kryesor nga ky tregim ... është që në një ambient ekonomik të ndryshueshëm, varësia e sistemit mund të jetë më shumë i cënueshëm nga mundësitë e punësimit se sa nga rrymat e pastra demografike. Nevojat e atjeshme nuk mund të jenë një ndryshim i madh në prodhim. Më mirë, faktorët vendimtarë mund të ndryshojnë në më shumë modele të përgjithshme të punësimit, të cilat mund të rezultojnë në dëmtim të rregullt të kontribuesëve tradicionalë. E ardhmja e sistemit të pensionit duket të jetë në duart e tregut të punës. Situata e tanishme e ekonomive në tranzicion mund të bëhet një shesh prove për një ndarje të paparë dhe të dëmshme midis sistemit dhe varësisë demografike.<sup>12</sup>

<sup>12</sup> Augusztinovics (1999), fq. 96.

**Figura 4. Pensionistët në përqindje me punonjësit në vendet e zgjedhura të EQL në dy vitet**



Burimi: Palacios, R., M. Rutkowski, dhe X. Yu, *Reforma e Pensionit në Ekonominë e Tranzicionit*, Washington, D.C.: Banka Botërore, Qershor 1999, dhe për Estoninë and Lituanië, Ministrinë e tyre respektivisht.

### C. Projektimet Demografike:

Ndonëse ndryshimet demografike nuk kanë filluar të ndihen në shumicën e shteteve, projektimet dëftojnë se ato e rrisin koston e ardhshme të pensioneve në mënyrë të konsiderueshme. Ashtu sikurse shikohet në Tabelën 3, popullsia në Europën Lindore është “e re” sipas standardeve Europiane.<sup>13</sup> Sot më të vjetërit (këtu të përcaktuar nga 65 e sipër) krijojnë vetëm mbi 12 % mesatarisht të popullsisë kombëtare, ku në Veri, Jug dhe në Europën Perëndimore ky grup është një çerek më i madh. Pritja mesatare e jetës është konsideruar gjithashtu e ulët në Europën Lindore në 68.9 vjeç krahasuar në 76.5 vjeç në Europën Perëndimore. Pritjet e ulëta të jetës, ndonëse jo një plus për individët që jetojnë në këto vende, zvogëlojnë përqindjet varëse në krahasim me pjesët e tjera të Europës.

**Tabela 3. Treguesit kryesor demografik në Europë sipas rajoneve gjeografike, 1990-1995**

	<i>Lindore</i>	<i>Veriore</i>	<i>Jugore</i>	<i>Perëndimore</i>
Përqindja bruto e lindjeve ( <i>për mijë</i> )	11.5	13.5	10.8	11.5
Përqindja bruto e vdekjeve ( <i>për mijë</i> )	12.2	11.3	9.5	10.6
Pritjet e jetës në lindje ( <i>vitet</i> )				
Meshkuj .....	63.8	72.7	73.0	73.0
Femra .....	74.1	78.7	79.3	79.7
Të dy gjinitë .....	68.9	75.7	76.2	76.5
Popullsia sipas grupmoshave (%)				
0-14 .....	21.0	19.7	17.3	17.6
15-64.....	66.7	65.2	68.2	67.1
65+ .....	12.3	15.2	14.5	14.9

Burimi: Augusztinóvics në *Vlerësimi Ekonomik i Europës* (1999), fq. 90

<sup>13</sup> Këto krahasime i referohen rajoneve gjeografike sesa grupimeve gjeo-politike.

Këto mesatare të larmishme rajonale maskojnë gjithashtu ndryshime domethënëse në strukturat kombëtare të moshës. Siç tregohet në Tabelën 4, Shqipëria bën kontrast të dukshëm me fqinjët e saj në të qënurit shteti “më i ri” në Europë. Më shumë se 40 % e popullsisë Shqiptare është nën moshën 20 vjeç dhe vetëm 9% është mbi moshën 60 vjeç. Grupi i moshës nën 20 vjeç është afërsisht 30% në Rumani, Maqedoni dhe Republikën Sllovaqe, ndërsa në shtetet që mbeten është afërsisht 25%.

Procesi i vjetërimit është në horizontin kombëtar afërsisht të të gjitha shteteve, siç tregohet në të dyja figurat 4 dhe 5.<sup>14</sup> Në 20 vitet e ardhshme grupi i të vjetërve do të rritet në një të tretën në shumicën e shteteve, ndërsa popullsia e re do të tkurret dukshëm. Ashtu sikurse strukturat kombëtare të moshës së tanishme ndryshojnë, vjetërimi është menduar të kalojë në përqindje shumë të ndryshme: Maqedonia, për momentin një shtet “ i ri”, plakja do të rritet mbi 70%, nga 13-23 % të popullsisë në gati 20 vjet. Ndërsa popullatat e tjera priten të plaken më ngadalë, vetëm Shqipëria do të vazhdojë të ketë një përqindje të ulët të plakjes pas më shumë se dy dekadave.

Se si këto përqindje të projektuara të varësisë demografike do të shpjegohen në përqindjet aktuale të varësisë në skemat kombëtare të pensioneve varet shumë nga faktorët ekonomikë dhe të tregut punëtor, si janë munësitë e punësimit dhe kushtet e punësimit, si dhe vendimet e rregullave lidhur me nivelin e të ardhurave të pensionit të siguruar, rregullave të ligjshme dhe moshës së daljes në pension. Akoma, po të llogarisim përqindjet e larta të varësisë së sistemit i cili egziston për momentin, duket që procesi i plakjes do të parashtrijë sfida të mëdha për shumicën e shteteve.

Një grup projektsh demografike afatgjatë e më të detajuara janë dhënë në shtojcat A dhe B.

---

<sup>14</sup> Parashikimet për afat më të gjatë të cilat përfshijnë varësinë e plakjes nga mosha janë dhënë në shkojcat B dhe C.

**Tabela 4. Përpjestimi i moshës së re punëtore dhe të moshës së vjetër ndaj popullsisë në përgjithësi (përqindjet)**

Shtetet	1998			2020		
	-19	20-59	60+	-19	20-59	60+
Shqipëria	42	49	9	32	55	12
Bullgaria	26	53	21	14	58	28
Republika Çeke	25	57	18	19	54	27
Estonia	27	54	19	18	56	25
Hungaria	26	55	19	NA	NA	NA
Letonia	26	54	20	18	57	25
Lituania	28	54	18	23	55	21
Maqedonia	33	54	13	23	54	23
Polonia	30	54	16	25	53	22
Rumania	31	52	16	NA	NA	NA
Sllovenia	24	57	18	22	52	26
Rep. Sllovaqe	30	55	15	19	58	22

Burimi: Konsensusi i Programit Phare (1998), fq. 63.

**Tabela 5: Vjetërsia (mosha 60 e sipër) në përqindje me popullatën kombëtare**

Shtetet	1998	2020
Shqipëria	19	22
Bullgaria	39	47
Republika Çeke	32	50
Estonia	40	45
Hungaria	35	NA
Letonia	37	44
Lituania	33	39
Maqedonia	25	42
Polonia	30	43
Rumania	31	NA
Sllovenia	32	49
Rep. Sllovaqe	28	38

Burimi: Konsensusi i Programit Phare (1999), fq. 63.

## II. Përfaqset e reformës

Nga mesi dhe më vonë vitit 1990, shumica e shteteve të EQL ndërmorrën reforma pensioni të shumta; por hapi marrjes së vendimeve dhe implementimit ka pasur një ndryshim të dukshëm nga një shtet në tjetrin. Në disa shtete, legjislacioni është aprovuar dhe po implementohet (p.sh., Hungaria, Polonia dhe Sllovenia), ndërsa në shtetet e tjera akoma po debatohet. (p.sh., Sllovakia, Ukraina). Reformat kanë për qëllim jo vetëm të zvogëlojnë përpjestimet e sistemit vartës por edhe të përshtasë disa nga faktorët e krijuar para tranzicionit në kushtet e reja ekonomike dhe politike. Në të gjitha rastet, kjo ka nënkuptuar një lëvizje më tutje nga politikat universale të rishpërndarjes drejt sistemeve në të cilat përfitimet janë më shumë individuale dhe të lidhura më të ardhurat. Në shumë shtete reforma ka shkaktuar gjithashtu një ngritje drejt mbështetjes më të madhe në sektorin privat të furnizimit me pension. Rezultati po rrit ndryshimet në të dyja brenda dhe midis shteteve në shkallë të sigurimit të mbrojtjes. Tabela 6 tregon zhvillimin e reformës së pensionit në shtetet e zgjedhura të EQL.

**Tabela 6. Statusi i reformës së pensionit në shtetet e zgjedhura të EQL**

Shteti	Shkalla e parë madhore e reformës (nën mandat)			Prezantimi i mandatit të radhës së dytë (plotësues)			Marrëveshjet vullnetare të shtuara		
	Në pregatitje	Aprovuar	Ligjësuar	Në pregatitje	Aprovuar	Ligjësuar	Në pregatitje	Aprovuar	Ligjësuar
Shqipëria			X						X
Bullgaria			X			x			X
Kroacia			X			X shtyrë*			X
Rep. Çeke			X						X
Estonia			X		tërhequr*				X
Hungaria			X			X			X
Letonia			X			X, vonuar për në 1/7/01			X
Lituania			X	X					X
Maqedonia			X			X			X
Polonia			X			X			X
Rumania			X		X		X		
Rep. Slovake		X		X					X
Sllovenia			X			kundërshtuar			X
Ukraina		X			X, shtyrë*			X	

\* Implementimi i ligjit Kroat është shtyrë nga qeveria e re duke pritur përmirësimet në ekonomi. Thërritjet e propozuara të Ukrainës për implementim vetëm në pikën kur kushtet paraprake të veçanta ekonomike dhe politike janë arritur. Qeveria e Estonisë tërhoqi një propozim për shtyllë mandatuëse, duke shprehur shqetësim për koston e lartë të tranzicionit.

*Burimi:* Konsensusi i Programit Phare (1999), fq. 55, *Pensionet Ndërkombëtare (çështjet 2000)*, dhe informacioni më i fundit siguruar nga pjesëmarrësit në konferencë.

Nga prespektiva kronologjike, ndryshimet më të hershme ndanë siguracionin social nga buxheti i shtetit dhe siguruan financim të ndarë ose llogari për lloje të shumta përfitimesh. Tani të gjitha shtetet kanë një buxhet për pensionin, llogari ose fond i cili është i dalluar nga buxheti i shtetit ose i veçuar brenda tij. Përveç kësaj, shtete të shumta, duke përfshirë Hungarinë dhe Republikën Çeke, kryen veprime të hershme për të ndërtuar vullnetarisht skemat plotësuese të pensionit. Këto kishin për qëllim të inkurajonin vetë-mbështetjen në moshën e vjetër, si dhe të siguronin kapital investues afatgjatë. Në përgjithësi, shfaqet se antarësimi në këto skema ka rënë shkurt në pritjet origjinale dhe, në disa raste, tërhoqi vetëm nivele të ulta të kursimeve nga anëtarët.<sup>15</sup>

Masat e mbetura të reformës ranë në dy kategori të gjera: përshtatje në parametrat bazë të skemave ekzistuese publike dhe ndërtimin e marrëveshjeve të reja private për parashikim të pensionit. Në të vërtetë të gjitha shtetet po ndjekin përjasjen e parë, ristrukturimin e skemave publike. Reformat në lëvizje e sipër përfshijnë moshën kombëtare të daljes në pension, duke ulur rishpërndarjen dhe përqindjen e zëvendësimit të pagës në formulat përfituese, duke prerë përfitimet e kategorive të punonjësve të privilegjuar ose duke siguruar një burim të ndarë për financimin e tyre, dhe duke forcuar procedurat për mbledhjen e kontributeve. Moshat e rritura të daljes në pension janë treguar në Tabelën 7. Siç mund ta shikoni, rritjet janë kthyer në ligj nga shumica e shteteve, në shkallë të dy – tre vite për burrat dhe tre – gjashtë vite për gratë. Shumë nga këto statute të reja janë rezultat i kompromiseve politike, më një rritje të madhe që u është propozuar së pari dhe zvogëluar nëpërmjet një procesi të negociatave me tregun e përbashkët dhe, në disa raste, punonjësit. Në shumë shtete (p.sh., Polonia, Sllovenia), barazimi i moshës të daljes në pension midis burrave dhe grave u propozua në fillim por u kundërshtua në favor të një ndryshimi të vazhdueshëm. Në disa shtete (p.sh., Republika Çeke dhe Letonia), raundi i dytë i rritjeve është një diskutim si një mënyrë për adresimin e moshës së pritjes së popullsisë.

Shtetet kanë ndjekur përjasje të ndryshme në përsëritjen e formulave të përfitimit. Letonia dhe Polonia kanë zëvendësuar sistemin tradicional të përfitimit të përcaktuar me të ashtuquajturën sistemi kombëtar i kontributeve të përcaktuar, në të cilin nivelet e përfitimit janë të vendosura të bazuara në daljen në pension nga koha jetësore e kontributeve të punëtorit dhe një çmim i mesatares së pritjes së jetës të grupit të moshës në të cilën ai ose ajo bëjnë pjesë në moshën e daljes në pension sipas standartit.<sup>16</sup> Sllovenia, në kontrast, mbajti një sistem përfitimi të përcaktuar, por me përqindje të ulët pensioni të përpiktë për secilin vit pune (një reduktim nga 2.0 në 1.5 % të pagës mesatare për çdo vit) dhe përdorimi i një

<sup>15</sup> Në Hungari, skemat vullnetare private kanë rreth një milion anëtarë jashtë popullsisë ekonomike të katër milionëve dhe një forcë aktive për punë prej 3.7 milion. Në Republikën Çeke, rreth 40 % e punonjësve morrën pjesë në 1999; por përqindjet e kontributeve ishin të ulëta, mesatarisht vetëm 2.5 % të pagës bruto, dhe një pjesë e lartë e këtij kursimi u tërhoq brenda një kohe relativisht të shkurtër.

<sup>16</sup> Kontributet përfshijnë disa interesa të fajësuar të bazuara në indeksin e pagës.

numri të madhe vitesh në llogaritjen e pagave mesatare, kështu duke forcuar marrëdhëniet midis të ardhurave jetësore të punonjësit dhe përfitimet e tij ose te saj. Rishikimet në formulat e përfitimit të trashëguara në tranzicion akoma janë nën konsiderim në disa shtete, p.sh., Republika Çeke, Sllovaqe dhe Ukraina.

Aksioni për të ndarë pensionet e privileguara është i çrregullt përmes rajonit. Disa shtete i kanë eliminuar këto lloj privilegje ose sigurimin e një burimi financiar për ta (p.sh., Hungaria, Republika Çeke, Lituania, Sllovenia), ndërsa në shtetet e tjera çështja mbetet në axhendën e politikave kombëtare (p.sh., Polonia, Republika Sllovaqe dhe Ukraina).<sup>17</sup>

Disa shtete të EQL po kërkojnë të përmirësojnë mbledhjet e kontributeve nëpërmjet të ashtuquajturave sisteme të mbledhjes së njëjësuar. Këtu një agjenci e vetme e detyruar mbledh kontributet për të financuar skema të shumta të siguracioneve sociale (p.sh., pensionet, kujdesi shëndetësor, papunësia, sëmundjet, lëndimet në punë) dhe mund të mbledhë dhe të ardhurat e taksave gjithashtu. Ky afrim rrit ekonomitë në shkallë të forcimit dhe i jep fuqi agjencisë, mundësi për informacion mbi iniciativat nga burimet e shumfishta të qeverisë. Ndërsa mbajnë premtimin për përmirësimin e mbledhjeve në sektorin formal, ky afrim është më pak i përdorshëm në arritjen e punëtorëve të vetpunësuar në sektorin joformal. Sistemet e njëjësuar të kontributeve janë zhvilluar në Letonia, Lituani dhe Poloni; dhe propozime janë nën konsiderim aktiv në Republikën Sllovaqe dhe Ukrainë.<sup>18</sup>

Kategoria e dytë e reformave, marrëveshjet e reja private për pension, ndryshojnë nga përjasjet e privatizimit në disa shtete të Amerikës Latine ku skemat publike u zëvendësuan plotësisht. Këtu objektiva në shumicën e shteteve është të strukturojë përzjerje të sistemeve të pensionit në të cilën pensionistët e ardhshëm do të marrin përfitime nga dy burime, skemat publike dhe radha e dytë e mandatit që ka të bëjë me llogaritë e kursimit individuale me drejtim komercial. Kjo marrëveshje eliminon bashkimin e rreziqeve dhe rishpërndarjen e të ardhurave me respektin për kursimet e investuara në radhën e dytë, duke u siguruar punonjësve një kthim të thjeshtë të kontributeve të tyre, plus të ardhurat e investimeve dhe duke i hequr shpenzimet administrative. Punonjësve zakonisht u jepet një zgjedhje pensioni i manaxhuar nga firma dhe e drejta për të transferuar nga një firmë në tjetrën. Kjo lloj marrëveshje ngre efektivisht rolin e qeverisë nga siguroes i përfitimeve në rregullator ballëpërballë të firmave private që përbëjnë raundin e dytë. Skemat e raundit të dytë me mandat u ndërmorrën në Hungari më 1998 dhe në Poloni më 1999. Siç tregohet në Tabelën 6, shumë shtete të tjera po planifikojnë gjithashtu reforma të tilla ose po i shqyrtojnë këto.

Të dyja përjasjet janë ndërmarrje të nevojshme me afat të gjatë, për shkak të vështirësive politike në ndërtimin e konsensusit për ndryshimet të cilat zvogëlojnë mbrojtjen sociale, koha e kërkuar për të ndërtuar sisteme të reja për individualizimin e administratës së pensionit dhe rregullimit të siguroesve privatë të pensioni, dhe nevoja e zbuluar në shumicën e shteteve për të evituar humbjet e papritura për punonjësit duke u siguruar udhëheqje me afat të gjatë për ndryshimet. Ndërsa e tanishmja e këtyre reformave e bën të vështirë të arrish rezultate të përcaktuara, shumë modele të hershme janë dalluar.

**Tabela 7. Mosha e pensionimit në vendet e zgjedhura**

	Ligji i tanishëm	Meshkujt	Femrat
--	------------------	----------	--------

<sup>17</sup> Në Republikën Sllovaqe, preferimet u eliminuan në mes të vitit 1990, por janë shtyrë cdo vit si përgjigje të kërcënimeve të demonstratave.

<sup>18</sup> Polonia i ka njëjësuar kontributet për siguracion social dhe kujdes shëndetësor por jo arkëtimin e taksave.

<b>Shqipëria</b>	1995	60 me 35 vjet përvojë; pension i pjesshëm me 20-35 vjet	55 me 35 përvojë 35 pune; 50 me 30 vjet përvojë pune dhe 6 fëmijë; pension i pjesshëm me 20-35 vjet
<b>Kroacia</b>	1998	Deri në vitin 2007 do të rritet në 65 vjet me 15 vjet punë. Pensioni i pritur ngritet në moshën 60 me 35 vjet punë.	Ngritet në 60 me 15 vjet punë deri në 2007. Pensioni i paraparë ngritet në moshën 55 me 30 përvojë.
<b>Republika Çeke</b>	1995	Ngritet nga 60 në 62 me 25 vjet përvojë, sipas shkallës prej 2 muajsh në vit ndërmjet v. 1996 dhe 2006.	53-57, varësisht nga numri i fëmijëve, ngritet në 57-61 sipas shkallës prej 4 muajsh në vit ndërmjet 1996 e 2007.
<b>Estonia</b>	1998 (në fuqi nga v. 2000)	62.5, ngritet në 63 në v. 2001.	57.5, ngritet në 63 në 2016.
<b>Hungaria</b>	1997	62	57, ngritet në 62 në 2009.
<b>Latvia</b>	1998	60 me 10 vjet sigurimi	57 me 10 vjet sigurim, ngritet në moshën 60 me indeks 6 muaj në vit.
<b>Lituania</b>	1994	61, ngritet në indeksin prej 2 muajsh në vit deri në 62.5 në v. 2009.	57, rritet në masën 4 muaj në vit deri në 60 në v. 2009.
<b>RFJ Maqedonia</b>	2000	Do të bëhet 64 (31/12/01) me 15 vjet punë. Periudha kalimtare deri në vitin 2005 deri kur punëtorët do të pensionohen me 35 vjet punë (pa moshë min.) nëse është më e favorshme.	Do të bëhet 62 (31/12/07) me 15 vjet punë. Periudha tranzitore deri në v. 2005 gjatë së cilës puntorët mund të pensionohen me 30 vjet punë (pa moshë minimale) nëse është më e favorshme.
<b>Polonia</b>	1998	65 me 25 vjet përvojë. Pensionimi i hershëm po hiqet.	60 me 20 vjet përvojë. Pensionimi i hershëm po hiqet.
<b>Rumania</b>	2000	Ngritet nga 62 (pensionim të hershëm 60) në 65 në v. 2013.	Rritet nga 57 (pensionimi i hershëm 55) në 60 në v. 2013.
<b>Republika Sllovaqe</b>	1988	Mosha normale e pensionimit 60; për profesione të zgjedhura, 55-58 me 25 vjet përvojë.	Mosha normale e pensionimit 53-56, varësisht nga numri i fëmijëve të rritur, me 25 përvojë.
<b>Sllovenia</b>	2000	Ngritet nga 61 në 63 për pensionim të plotë me 40 vjet periudhë kualifikuese, mosha minimale e pensionimit 58.	Ngritet nga 58 në 58-61 për pensionim të plotë, me 38 vjet periudhë kualifikuese, mosha minimale e pensionimit 58.

Burimi: Sigurimi *Social nëpër Botë* (Administrata e SHBA-ve e Sigurimit Social, 1999), Asociacioni Ndërkombëtar i Sigurimit Social, *Baza e të dhënave – Sigurimi Social në tërë botën* ([www.issa.int](http://www.issa.int)), Konsensusi Phare (1999), f. 33-8; dhe Azhurimi i informativë të siguruar nga pjesëmarrësit e konferencës.

1. *Kostoja e tranzicionit për kalim në skemë të kombinuar pensionale janë më të larta se që ishte projektuar në Hungari e Poloni, për shkak të preferimit të madh të punëtorëve për pensione private.* Këto vende kanë shpenzime duke kaluar prej sistemit të pagesës momentale në ato të kombinuara sepse duhet të krijojnë rezerva për të rejtat që shtresën e parapaguar dhe në të njëjtën kohë t'i kryejnë obligimet ndaj pensioneve momentale. Në EQL ky akumulim shkakton probleme specifike, sepse ato vende veprojnë nën kufizime të cilat e ndalojnë rritjen e kontributeve. Ky kufizim del nga shkallët e tashme të kontributeve, që janë të larta krahasuar me pjesët e tjera të botës (shih Tabelën 8).<sup>19</sup> Qeveritë që synojnë të jenë konkurrenente në rafshin ndërkombëtar janë nën presion për t'i ulur këto shkallë të kontributeve dhe kështu t'a mbulojnë koston e tranzicionit në mënyra të tjera.

<sup>19</sup> Analiza të shumta ekonomike tregojnë se janë pikërisht punëtorët ata që i paguajnë kontributet e sigurimit social me të cilat ngarkohen punëdhënësit, me ndryshime të caktuara që ndodhin me ngritjen e pagave më të ulëta kohëpas kohe. Shih, për shembull, Brittain, John A., *Taksa nga lista e pagave për sigurim social*, Washington, D.C.: Institutu Brookings, 1992. Megjithatë, përkundër këtij konstatimi, kontributet për sigurimin social vazhdojnë të mbesin një bringë e madhe për punëdhënësit si dhe temë e debateve politike për konkurrueshmërinë ndërkombëtare.

Duke punuar nën shtrëngesa të tilla, qeveria polake i ka riorientuar një të pestën e mjeteve të mbledhura nga skema publike për ta financuar skemën private (7.3 % nga 32.52 përqind e shkallës së kontributit për secilin anëtarë të dytë të kësaj skeme). Planifikon që ta zgjedhë deficitin e shkaktuar duke huazuar më shumë, përmes lëshimit të letrave me vlerë për t'i kompensuar kontributet e ndara për sistemin e ri privat. Edhe në Hungari qeveria i ka riorientuar rreth një të tretën e kontributeve (6 përqind nga 30 përqind të shkallës së kontributit për secilin anëtarë të dytë të skemës së dytë për grupin e ri të formuar). Edhe kjo do ta mbulojë deficitin në sistemin publik duke lëshuar borxhe shtesë.<sup>20</sup>

**Tabela 8. Shkalla e kontributeve të punëtorëve dhe të punëdhënësve në vendet e zgjedhura, 1999\* dhe 2000\*\***

<i>Vendi</i>	<i>(% e të ardhurave të me sigurim)</i>	
	<i>Punëdhënësit</i>	<i>Të punësuarit</i>
Shqipëria*	26	10
Bullgaria*	34.7	1
Kroacia**	8.75	10.75
Republika Çeke**	19.5	6.5
Estonia**	20	
Hungaria**	22	8 <sup>1)</sup>
Letonia*	23.58	9
Lituania**	22.5	2.5
IRJe	20	
Macedonisë*		
Polonia**	16.26	16.26
Rumania*	23 <sup>2)</sup>	5 <sup>3)</sup>
Slllovenia*	15.5 <sup>4)</sup>	8.85 aver <sup>5)</sup>
Slllovakia*	21.6	5.9

<sup>1)</sup> Për punëtorët në sistemin e kombinuar, pikët 6 përqindëshe shkojnë në fondin e paguar privat, 2 në sigurimin social

<sup>2)</sup> 23% për kushte normale të punës; për kushte të rënda dhe shumë të rënda pune shkallët e kontributit janë 28% e 33%.

<sup>3)</sup> Për pensionet plotësuese.

Shkallë të ndryshme të kontributit, mesatarisht rreth 15.50% e të ardhurave. (1 punësuarit e paguan tërë koston, punëdhënësi e kompenzon të punësuarin për kontributet e punëdhënësit)

<sup>5)</sup> Shkallë të ndryshme kontributesh, mesatarisht 8.85% e rrogës.

Vërejtje: Këto shkallë nuk janë plotësisht të krahasueshme pasi që aplikohen për baza të ndryshme të të ardhurave në disa vende, e në të tjerzbatohen vetëm për të ardhurat deri në një plafon.

Marrë nga: Phare Consensus (1999), f. 49 e SSA (1999), f. 286; për Kroacinë, Fakulteti Juridik, Dega e Punës Sociale,

Universiteti i Zagrebit; Republika, Çeke, Ministria e Punës e Çështjeve Sociale; për Estoninë, Ministria e Punëve Sociale;

për Hungari, Instituti i Ekonomisë i Akademisë Hungareze të Shkencave; për Lituaninë, Njësia e Politikës Sociale e Lituanisë dhe për

Poloninë Ministria e Punës.

Ngritja e koston së tranzicionit mbi projeksionet e mëhershme rrjedhë nga fakti se qeveria ua mundësoi një pjese të madhe të fuqisë punëtore që të vendosin nëse do t'i bashkoheshin një skeme të re ose jo. Në Poloni kjo iu mundësua të gjithë punëtorëve prej moshës 30 deri 50 vjeçare, ndërsa në Hungari të gjithë të punësuarve të tanishëm.<sup>21</sup> Në secilin

<sup>20</sup> Simonovits, A., "Sistemi i Ri Pensional në Hungari dhe Problemet e tij," në Katharina Muller, Andreas Ryll, e Hang-Jurgen Wagener, redaktorë., *Transformimet e Sigurimit Social: Pensionet në EQL*, (Heidelberg: Physica-Verlag, 1999), f. 220.

<sup>21</sup> Opcionet me të cilat ballafaqoheshin punëtorët ndryshonin në këto dy vende. Në Poloni, të gjitha ata të moshës prej 30 deri 50 vjeçare ishte dhënë mundësia që t'i investonin të gjitha kontributet e veta në ardhmen ose në skemën e re të definuar rishtazi ose ndarja e një pjese në fond privat. Në Hungari, duhej zgjedhur në mes

rast, numri i punëtorëve që kaluan në skemën e re i kalonte shumë vlerësimet zyrtare.<sup>22</sup> Në Poloni, derisa qeveria kishte vlerësuar se 6 milionë punëtorë do të kalonin në skemën e re, ndërsa në të vërtetë kaluan 10.6 milionë. Për këtë arsye qeverisë iu desht që t'i rris subvencionet e shtetit për skemën publike për vitin 2000 për 2.7 miliardë PLN (650 milionë dollarë amerikan) mbi nivelin e vitit 1999.<sup>23</sup> Në Hungari ishte vlerësuar se 800,000 punëtorë do të kalonin në v. 1998, por në të vërtetë kaluan 1.4 milionë, dhe që nga ajo kohë anëtarësia e skemës private është rritur në më se 2 milionë. Në këtë situatë, qeveria Fidesh e revokoi legjislacionin duke i riorientuar 2 për qind të mjeteve shtesë të shkallës së kontributit prej 31 % për fondet private, duke e lënë shkallën për shtresën e dytë në 6 në vend të 8 %.<sup>24</sup> Duke e llogaritur këtë revokim, vlerësohet se mjetet e fondeve private do të arrijnë 35 % të BPSH-së gjatë këtij shekulli krahasuar me një projeksion të mëhershëm prej 47.6 %.<sup>25</sup> Pasi që janë ulur dukshëm të hyrat e ndara për kursimet private, garancat statutare të shtresës së dytë do të shtohen gjatë viteve të ardhshme, duke i ngritur kështu koston e reformës.<sup>26</sup>

2. *Kostoja administrative e firmave private tregtare i ka tejkaluar mjetet e ndara gjatë vitit të kaluar, duke i kontribuar humbjeve financiare dhe presioneve për konsolidim.* Privatizimi i pesioneve i kryer në vendet e tjera të botës (p.sh. në Kil dhe në Mbretërinë e Bashkuar) tregon se menaxhimi privat do të jetë i kushtueshëm.<sup>27</sup> Kjo vjen pjesërisht nga reduktimi i ekonomive të mëdha që është inherent në sistemet me shumë firma të menaxhuara privatisht, pjesërisht nga nevoja për t'i lejuar punëtorët që të lëvizin nga një firmë në tjetrën, dhe pjesërisht nga shpenzimet propaganduese që kanë firmat private duke garuar për anëtarë. Në Hungari, shpenzime operative silleshin në shkallën rreth 8 % të të ardhurave nga kontributet gjatë vitit 1999, ose katër here më shumë se shpenzimet administrative në skemat publike të pensioneve. Megjithatë, të hyrat dolën të kishin qenë të pamjaftueshme, që kërkonte nga kompanitë garantuese (p.sh. bankat dhe kompanitë e sigurimit) që, kohë pas kohe e, në disa raste edhe shpesh, të siguronin subvencione.<sup>28</sup> Në Poloni, shpenzimet administrative të firmave të drejtuara privatisht kanë pasur fluktuime të konsiderueshme gjatë një periudhe të shkurtër prej se janë themeluar. Kah mesi i vitit 1999, ato silleshin prej 13-15 % të të hyrave nga kontributet, mirëpo ranë në 6.5-10 % si rezultat i përpjekjeve të firmave për të tërhequr më shumë klientë në fund të afatit të caktuar për kalim në fondet private.<sup>29</sup> Në fund të vitit 1999, të gjitha firmat kishin regjistruar humbje të konsiderueshme (1.6 miliardë PLN, ose 403 milion dollarë amerikan). Kjo vinte në rend të parë nga shpenzimet e mëdha

---

të mbetjes në skemën publike (me një formulë paksa të modifikuar) ose bartjes së një pjese të kontributeve të ardhshme në një fond të menaxhuar privatisht.

<sup>22</sup> Preferimi i punëtorëve për pensione private bazohet në disa faktorë: fushatat intensive propaguese të firmave private; shpresat e punëtorëve që të kenë përfitime të mëdha në tregun e aksioneve; pranueshmëria më e madhe për ta e marrëveshjeve të individualizuara private të të gjitha llojeve; dhe mungesa e besimit në skemat publike, për shkak të mungesës së transparencës të sistemit të vjetër socialist të pensioneve, si dhe për shkak të lidhjes në mendjen e punëtorëve të skemës publike pensionale me qeveritë e mëparshme. Shumë punëtorë polkaë, për shembull, e shihnin ZUS-in si simbol të sistemit të vjetër. Chlon Agnieszka, "Reforma e Pensioneve dhe Informimi Publik në Poloni", në *World Bank Pension Reform Primer*, 2000, f. 23.

<sup>23</sup> *Pensions International*, Janar 2000, p. 6.

<sup>24</sup> Legjislacioni kërkonte një rritje deri në 7 % në janar 1999 dhe 8 % në janar 2000.

<sup>25</sup> Paraqitje nga Tibor Parniczky, Mbikqyrja Shtetërore e Fondeve private në Hungari, Në Konferencën e OECD-së mbi pensionet private, Pragë, 3 prill, 2000.

<sup>26</sup> Përmes një formule shumë komplekse garantuesi statutar deklaroi se asnjë punëtorë nuk do të humb më shumë se 7 % të beneficioneve që ai apo ajo do t'i kishte fituar në sistemit publik. Simonovits (1999), f. 222.

<sup>27</sup> Kostja administrative vlerësohet t'i ketë konsumuar rreth 40 % të kontributeve të punëtorëve gjatë jetës së një njeriu në Britaninë e Madhe dhe 25 % në Amerikën Latine. Quiesser, Monika, "Në drejtim të zgjedhjeve më të individualizuara në mbrojtjen sociale?" paraqitur në një konferencë të ISSA, Luksemburg, 19-21 Maj, 1999.

<sup>28</sup> Mbikqyrja e Fondeve Private nga Shteti, *Raport për tremujorin e tretë të v. 1999*, f. 16.

<sup>29</sup> *Pensions International*, Nëntor, 1999, f. 6.

promovuese, përqindjes së agjentëve dhe marketingu; kjo e fundit i kishte kaluar 400 million PLN (100 million dollarë amerikan).<sup>30</sup>

Në të dyja vendet, mundësia e shpërndarjes së kostos së lartë operative në numër sa më të madh të anëtarëve po shkakton shkallë të lartë të përqendrimit të tregut dhe nisjen e procesit të konsolidimit. Që nga shtatori i vitit 1999, në Hungari vepronin 39 fonde private mandatore pensionale, 6 prej të cilave i kishin 80 % të të gjithë anëtarëve. Planifikuesit parashohin se konsolidimi do ta ulë numrin e firmave për dy të tretat, përafërsisht në 10, deri në vitin 2004. Në Poloni, deri në prill të vitit 2000 ishin regjistruar 21 fonde, 3 prej të cilave e kishin 70 % të tregut ndërsa po vazhdojnë bisedimet për bashkimin e një numri të kompanive të vogla.<sup>31</sup>

3. *Ligjet e privatizimit po futen në zbatim pa i pas zgjedhur çështjet kyçe të pagesës së beneficioneve.* Ligjet hungareze e polake të privatizimit përmbajnë pak hollësi mbi pagesën e beneficioneve dhe, gjatë zbatimit të tyre, të dyja qeveritë e kanë vënë theksin në mundësimin këtyre kompanive që të punojnë, duke e shtyer edhe më zgjedhjen e çështjeve të pagesës. Në Hungari ka një pasiguri të madhe lidhur me përshtatjet me inflacionin, të cilat, sipas ligjit, duhet të bazohen me proporcion të barabartë të pagës vjetore dhe të ndryshimit të çmimeve. Përderisa qeveria është në gjendje ta garantojë një mbrojtje të këtillë për shkak të mbledhjes së taksave, mbetet e paqartë se si do ta bëjnë këtë firmat private.<sup>32</sup> Çështjet e pazgjidhura janë edhe më të mëdha në Poloni, dhe kanë të bëjnë me: (i) mënyra e kthimit të kursimeve të akumuluarra të punëtorit në pension në kohën e pensionimit si dhe shpenzimet përcjellëse (a do të jenë disa kompani garuese pensionale apo një kompani kombëtare?); (ii) nëse do të merret parasysh moshë mesatare e meshkujve dhe femrave gjatë llogaritjes së pensioneve (me fjalë të tjera, tabela jetësore njëgjimore apo specifike gjimore); (iii) si do të indeksohen beneficionet private; dhe (iv) nëse do të ketë dispozita për tërheqjen e një shume të caktuar në kohën e pensionimit. Me këto çështje kryesore të pazgjidhura, punëtorët të cilëve u ishte dhënë mundësia për të zgjedhur vetëm një here nëse do t'i bashkoheshin një skeme private të kursimeve, nuk kanë mundur të vendosin si duhet për shkak të mungesës së njohurive për to. Mungesa e informative për këto çështje, poashtu e përjashton edhe mundësinë e vlerësimit të reformave përkitazi me kriterin kryesor të sigurimit pensional.

4. *Firmat private për menaxhimin e pensioneve investojnë më të madhe e më me dëshirë në asetët publike se sa në ato private.* Përkrahësit e privatizimit të pensioneve ofrojnë si argument kyç mundësinë që punëtorët të kenë beneficione më të mira në sigurimin privat. Megjithatë, në Hungari dhe Poloni, shumica e kursimeve të pensioneve private investohen në asete publike. Në Poloni, 68 % e kursimeve të punëtorëve janë investuar në aksionet e Thesarit dhe të BPP-së në fund të vitit 1999, me 28 % në aksione. Kjo pjesë u trefishua në mes shtatorit dhe dhjetorit të v. 1999, pasi që firmat orvateshin ti ngrisin fitimet për të tërhequr më shumë klientë në javët e fundit të regjistrimit të anëtarëve. Në Hungari, tendenca për investim publik është edhe më e theksuar: në fund të vitit 1999 përafërsisht 85 % e fondeve ishin investuar në letrat me vlerë të qeverisë ndërsa 9 % në letra me vlerë të korporatave. Pos kësaj shumica e madhe këtyre investimeve publike janë sigurime

<sup>30</sup> *Pensions International*, Qershor 2000, në [www.pensionsinternational.co.uk](http://www.pensionsinternational.co.uk).

<sup>31</sup> *Pensions International*, July 2000, "Pritet Konsolidimi i Fondeve Polake," në [www.pensionsinternational.co.uk](http://www.pensionsinternational.co.uk).

<sup>32</sup> Një qasje do të ishte nëse qeveria do të lëshonte letra me vlerë, realizimi i të cilave do të indeksoheshin për inflacionin dhe ngritjet e pagave. Disa vende të zhvilluara ofrojnë letra me vlerë të inflacionit të indeksuar, por askush deri më sot nuk ka ofruar indeksimin e të ardhurave; ndërsa qeveria hungareze nuk lëshuar ende kurrfarë forme të sigurimeve.

afatshkurta e jo afatgjata.<sup>33</sup> Nivelet shumë të ulëta në Hungari i reflektojnë uljengritjet e shpeshta në bursën e Budapestit, indeksi kryesor i të cilës i humbi dy të tretat e vlerës së vet të mëparshme me rastin e krizës ruse; ndërkaq, firmat e menaxhimit të pensioneve i redukuan investimet e veta për gjysëm, prej 14 në 7 %. Për fillim të vitit parashihej një ringjallje e tregut, mirëpo, pasi që një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur, fondet pensionale vazhdojnë të investojnë me kujdes.

5. *Ndërrimet e shpeshta në qeveritë e EQL po rezultojnë me revidimin e politikave në gjysëm të rrugës.* Ndërrimet e qeverive kanë qenë një fenomen i vazhdueshëm në shumë vedne të EQL-së: që nga viti 1990 Latvia i ka pasur 5 qeveri, Lituania, Sllovakia e Sllovenia kanë pasur nga katër; Estonia, Republika Çeke, Hungaria e Polonia kanë pasur nga tri; ndërsa Kroacia dy.<sup>34</sup> Ndikimi në reformën e pensioneve duket se ndryshon varësisht nga faza e zbatimit. Përderisa një propozim i reformës është duke u shqyrtuar, ndryshimi i qeverisë mund të shkaktojë ndërrimin ose kthimin e politikës; mirëpo, pasi të jetë miratuar, mund të pritet vetëm ndikim në formë të përshtatjes gjatë zbatimit. Paradigma e parë haste në Republikën Çeke dhe në atë Sllovaqe: qeveria e tashme çeke ka hequr dorë nga planet e të mëparshme për privatizim në favor të reformave të sistemit të tashëm publik, ndërsa qeveria e tashme sllovaqe e ka braktisur planin e qeverisë së mëparshme që shkonte sipas modelit çek të reformimit të sistemit publik, në favor të privatizimit. Variacione të paradigmës së dytë vërehen në Latvi dhe Hungari. Në Hungari, liderët e qeverisë Fidesh e kundërshtonin privatizimin e pensioneve derisa ishin pakicë, ndërkaq, pas kthimit në pushtet e anuluan një dispozitë, sipas të cilës do të rriteshin shkallët e kontributeve të ndara për një shtyllë të re të kursimeve private (nën ndarja 1, më lartë). Në Kroaci, qeveria e re në fillim e shtyri zbatimin e një ligji të miratuar nga qeveria e Tugjmanit, mirëpo, në muajt e fundit, i ka shpejtuar përpjekjet për implementimin e tij.<sup>35</sup> Në Latvi, reforma e pensioneve e vitit 1997-deri më tani është plotësuar nëntë herë, ndërsa kah fundi i vitit 1999 iu nënshtrua një referendum kombëtar; këto ngjarje e ngadalësuan privatizimin, por qeveria e re i ka dhënë privatizimit një nxitje të re. Duke i parë këto dukuri, një pjesmarrës i konferencës së Pragës vërejt:

Si duket është në natyrën e reformave pensionale që, një herë me t'u futur në lëvizje, është shumë vështirë të kthehen prapa. Pas një pike të caktuar, nuk ka më kthim prapa. Qeveritë nuk e kanë të lehtë ta zbrapsin një reformë të madhe, kështu që fillojnë të ndikojnë mbi gradualisht. Qeveria e re dëshiron të lë një shenjë të veten, kështu që së shpejti shohim një "politikë të re të re reformuese."

Polonia paraqet një përjashtim nga kjo paradigmë, i cili vlenë të përmendet: atje, ndryshimi i qeverisë në vllugun e planeve për reformë (kah fundi i vitit 1997) nuk pat ndonjë ndikim me rëndësi në ristrukturimin e pensioneve. Kjo i atribuohet në rend të parë përkrahjes së gjerë të publikut për reformat dhe, në veçanti, konsensusit trepalësh në favor të të raundit të dytë dhe të tretë. Duke e pasur parasysh këtë përkrahje, partitë u morën vesh që mos ta pengojnë reformën e pensioneve dhe që të mos e bënin çështje të fushatës zgjedhore.

6. Në shumë vende, megjithatë, dialogu shoqëror mbi reformën pensionale, është i kufizuar dhe konsensusi trepalësh arrihet shumë rrallë. Në Hungari, sindikatat, njësoj si edhe ekspertët e këtij vendi, ishin të përçara sa i përket reformës radikale pensionale. Në Slloveni, konsensusi ishte arritur vetëm në nivel parlamentar pasi që kërkesa për një shtyllë mandatore private ishte hequr nga legjislacioni i reformës. Në Kroaci e Maqedoni, ishin miratuar ligjet për reforma radikale përkundër kundërshtimeve të fuqishme të sindikatave, të cilat ende vazhdojnë para punës së parlamentit. Mosarritja e konsensusit ndodh për shkak të kundërshtimeve të sindikatave ndaj prerjeve të beneficioneve të cilat punëtorët mendojnë se i kanë fituar dhe të cilat i presin; mirëpo, kjo situatë nuk është karakteristike vetëm e këtij

<sup>33</sup> Më saktësisht 54 % janë në letra me vlerë të qeverisë në afat prej më pak se një viti, ndërsa 20 % janë në letra me vlerë të fatizuar për një ose dy vjet. Mbikqyrja Shtetërore e Fondeve Pensionale, *Raporti për tremujorin e tretë të vitit 1999*, f. 9.

<sup>34</sup> Economist Intelligence Unit, *Country Profiles for 2000*, at [www.eiu.com/schedule](http://www.eiu.com/schedule). Në shërbim të këtij krahasimi, llogariten ndërrimet e qeverisë vetëm nëse ato kishin ardhur si rezultat i zgjedhjeve të përgjithshme ose për shkak të ndryshimeve në një parti politike. Nëse do të llogaritnim ndryshimet Brenda partisë në pushtet ose të koalicioneve në mes të zgjedhjeve, numri do të ishte edhe më i lartë. Për shembull, në Lituani, numri i tërësishëm i ndërrimeve të qeverisë është njëmbëdhjetë (shih web-faqen e qeverisë së Lituani në [www.lrvk.lt](http://www.lrvk.lt)), ndërsa numri i ndërrimeve që përfshinte ndryshime në partinë në pushtet ose koalicionin, ishte katër.

<sup>35</sup> Sipas amandamenteve të aprovuara në qershor 2000, raundi i dytë mandatorë do të fillojë me 1 janar 2002.

rajoni. Megjithatë, vendet e EQL-së kanë edhe vështirësi të tjera që rrjedhin nga mungesa traditës së konsultimeve me partnerët socialë, për shkak se disa qeveri nuk e shohin një gjë të tillë fare të nevojshme, si dhe për shkak të mungesës së përvojës në radhët e punëtorëve dhe të punëdhënësve për ta luajtur rolin e vet. Këto vështirësi janë theksuar viteve të fundit edhe më me peshën më të madhe që i jepet efekteve makroekonomike në debatet për reformën e pensioneve (që do të thotë, ngritja e shkallëve kombëtare të kursimeve dhe të investimeve), që paraqet një ndryshim që i ka qitur në hije çështjet themelore të mbrojtjes sociale si dhe ka bërë që të marginalizohet roli i partnerëve socialë. Përderisa ky ndryshim do të ketë pasoja më të mëdha për sindikatat, ai megjithatë do të ndikojë edhe në asociacionet e reja të punëdhënësve të rajonit. Vështirësi të ngjajshme ka edhe me bordet tripalëshe të skemave pensionale në disa vende ku përfaqësuesit e punëdhënësve e të të punësuarve nuk janë edhe aq të sigurt për rolin e vet dhe për parimet e punës së skemave të sigurimit social. Kjo mungesë e përvojës pasqyrohet në pakënaqësitë me efikasitetin në punë të bordeve në disa vende.<sup>36</sup>

7. *Po rritet diversiteti i reformave në rajon: në njerën anë po ngadalësohet ritmi i privatizimit në disa vende, ndërsa në të tjera po bëhen përpjekje për ristrukturimin e sistemeve ekzistuese publike.* Zbatimi i reformave radikale në Hungari e Poloni i shtyri disa analistë të parashikojnë se shumica e vendeve të EQL-së do ta ndiqnin shembullin e tyre.<sup>37</sup> Siç mund të shihet në tabelën 6, disa qeveri të tjera tashmë kanë miratuar statute të ngjajshme ose janë në faza të ndryshme të shqyrtimit ose të planifikimit të tij. Megjithatë, ky ritëm u ngadalësua paksa gjatë vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000. Në Rumani, parlamenti e ka miratuar legjislacionin për ristrukturimin e skemës publike në vitin 2000, mirëpo tashmë një vit është duke debatuar për privatizimin e pensioneve pa asnjë zgjidhje.<sup>38</sup> Në Ukrainë, qeveria reagoi ndaj kundërshtimeve të reformave radikale duke e plotësuar propozimin e vet me kritere shumë të qarta që e shtyenin zbatimin e një raundi të dytë mandatorë deri në përmirësimin e gjendjes ekonomike e financiare të vendit.<sup>39</sup> Në Estoni, qeveria hoqi dorë nga themelimi i një rendi mandatorë rivat për shkak të shqetësimeve për koston e lartë të tranzicionit. Në vend të kësaj është duke e riformuluar legjislacionin për themelimin e një rendi të dytë opcional me subvencione nga skema publike për ata që marrin pjesë në të.

Pos kësaj, disa qeveri kanë miratuar strategjitë e reformimit të cilat angazhohen për ristrukturimin e skemave të veta publike në vend të privatizimit. Në dhjetor 1999, parlamenti sllloven e hoqi një propozim për një skemë të re mandatore për të gjithë të punësuarit në

<sup>36</sup> Në Hungari, bordi pensional dypalësh u shpërnda nga qeveria e tashme e Fideshit pas marrjes së pushtetit dhe pas akuzave për korrupsion, të cilat asnjëherë nuk janë hetuar. Në Lituani, qeveria i kufizoi autorizimet e bordit pensional (ia mori autorizimin për ta emëruar drejtorin e skemës) për shkak të ngathtësisë në mbikqyrjen e skemës. Në Republikën Sllovaqe, bordi drejtues i skemës kombëtare pensionale është relativisht pasive, pjesërisht për shkak të autorizimeve të kufizuara të dhëna nga qeveria.

<sup>37</sup> Për shembull, një parashikim i tillë u bë nga Banka Botërore e cila e përkrah privatizimin në EQL. Zyrtarët e bankës shpesh e paraqesin një hartë me pjesën më të madhe të errësuar deri në vitin 2100, duke treguar zbatimin e sistemeve mandatore të raundit të dytë.

<sup>38</sup> Pyetja më e madhe në këtë debat është nëse tregjet e kapitalit në Rumani janë sa duhet të rregulluara dhe të zhvilluara për ta duruar një rend të dytë mandator. Dyshimet u riaktualizuan në maj 2001, kur u rrënuar fondi më i madh i investimeve në Rumani. I drejtuar nga anëtarë të ish policisë sekrete komuniste, fondi i kishte 300.000 investitor dhe i menaxhonte 120 milionë dollarë. Ata kishin deklaruar pa mbështetje se depozitat ishin të siguruara. Drejtuesit i tërhoqën investimet e veta para se të binte skema. *Financial Times*, "Zemërimi i rumunëve për shkak të rrënimit të fondit," 31 tetor 2000, f. A-2.

<sup>39</sup> Këtu përfshihen 1) nuk ka deficit në skemën publike pensionale, 2) deficiti i buxhetit shtetëror më i vogël se 1 % e BPSH-së, 3) dy vjet të rritjes ekonomike në shkallë kombëtare, 4) zhvillimi i sistemit bankar dhe i tregjeve kombëtare financiare (nuk sqarohet se çfarë nënkuptohet me zhvillim), 5) vendosja e një sistemi të mbajtjes së shënimeve për secilin person për kontribuesit e pensioneve si dhe lansimi i një sistemi të unifikuar të mbledhjes, dhe 6) shqyrtimi i përvojës së skemave vullnetare kursimore.

sektorin privat, nga një projektligj për reformë të gjithëmbarshme të pensioneve, duke i miratuar dispozitat të cilat përforconin financimin e skemës ekzistuese publike.<sup>40</sup> Në Republikën Çeke, parashikimet për kosto të lartë tranzicionale e shtyen qeverinë e tashme që të heq dorë nga planet e qeverisë së mëparshme për privatizim. Përderisa ende vazhdon procesi i vendosjes për refomim të sektorit publik, rasti i këtyre dy vendeve sugjeron një paradigëmë tjetër të reformës së pensioneve në EQL e cila shërben për forcimin dhe ristrukturimin e sistemit ekzistues publik.

### III. Konkluzion

Këto paradigma të hershme nuk mund të merren si tregues të rezultateve të ristrukturimit të pensioneve në plan afatgjatë, sepse disa mund të zhduket me kalimin e kohës e disa ndryshohen nga ngjarje dhe kushte të cilat ende nuk janë të dukshme. Megjithatë, ato tregojnë disa befasi, krahasuar me projeksionet e mëhershme dhe e bëjnë të nevojshme që të rishikohen kërkesat dhe parashikimet e bazuara në to. Çfare konkluzionesh duhet të nxirren në këtë fazë? Autorët ofrojnë tri vërejtje përfundimtare.

Së pari, përvoja e hershme nuk flet fuqishëm në favor të reformave radikale për ambientin politik e ekonomik të EQL-së. Në Hungari e Poloni, kostoja e lartë e tranzicionit i shtyri që të ndërtohet një rend privat i parapaguar në ndërkohë duke vazhduar përmbushjen e obligimeve ndaj beneficioneve momentale: të dyja këto e kanë ngritur koston e reformës së ristrukturimit të sistemit ekzistues më shumë se sa do të duhej të ishte (rreth 0.5 – 1.3 % e BPSH në vit). Pos shkallëve të tanishme të larta të kontributeve, kjo kosto po e ngritë konsiderueshëm edhe barren e financimit të pensioneve në të dy vendet; kjo do ta bëjë shumë të vështirë përmbushjen e kufizimeve fiskale të caktuara nga Bashkimi Evropian.<sup>41</sup> Për më tepër ndalesa për ngritjen e kontributeve që është krijuar nga kontributet tashmë tepër të larta sjellë deri te ndërvarshmëria financiare e rendit të parë dhe të dytë, duke e bërë të mundshme pagesën e beneficioneve private vetëm nëse ia merr sistemit publik pensional të hyrat ose e kundërta. Të dyja këto skenare paraqesin rreziqe që e kërcënojnë, në mënyra të ndryshme, sigurinë e ardhshme pensionale të punëtorëve.<sup>42</sup> Kuptuarja e këtyre ngarkesave e rreziqeve është pasqyruar në vendimet e disa qeverive që të mos ndërmerret ristrukturimi radikal i pensioneve.

Përkitazi me paradigmat e investimeve, përqendrimi i kursimeve private në sigurime publike e jo private, mund të jetë strategjia më e mençur në vendet e EQL, nëse dihet paqëndrueshmëria dhe madhësia e tregjeve financiare private; porse, kjo do të thotë edhe se punëtorët do të privohen nga përfitimet më të larta që do t'i sjellin investimet private (megjithë rrezikimin më të madh). Pa të ardhura më të larta, pagesat e larta administrative të menaxhuesve privat mund t'i dëmtojnë kursimet dhe t'i ulin pagesat e beneficioneve në të ardhmën. Kjo paradigëmë e korrigjimeve të politikës në gjysëm të rrugës, e vërejtur në disa vende të EQL-së, nuk i përshtatet reformave radikale, të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë për implementim. Megjithëse është e vështirë të parashihen rezultatet e prioriteteve të ndërrueshme politike (për shembull kur qeveria e Fideshit refuzoi ngritjen e të hyrave të raundit të dytë), megjithatë ato do të jenë të ndryshme nga rezultatet e projektuara në fillim kur ishte miratuar reforma radikale.

Disa studiues thonë se, përkundër këtyre vështirësive, privatizimi mbetet qasja më e mirë e ristrukturimit të pensioneve në EQL, pasi që vetëm reformat radikale mund ta përballojnë rezistencën e grupeve të fortifikuara si shoqata e pensionerëve dhe sindikatat. Megjithatë, përvoja nuk e trgon të njejtën gjë. Siç u pa në pjesën e dytë, privilegjet e pensionale janë prerë në Republikën Çeke, në Slloveni e në Lituani edhe pa privatizim, ndërsa Polonia po merret intensivisht me këtë çështje para miratimit të ligjit të privatizimit. Të trija këto vende kanë arritur ta ngrisin moshën e pensionimit, ndërsa Sllovenia ka miratuar legjislacion të rendësishëm reformues që do të bëjë që pensionistët e ardhshëm të marrin rrum 25 % më pak se pensionistët e

<sup>40</sup> Siç është përshkruar më lartë, këto përfshijnë një rritje të moshës së pensionimit, një prerje të konsiderueshme në beneficionet e ardhshme (25 %), si dhe një limit në indeksimin e pagesave të pensioneve. Zyrarët e Ministrisë së Punës e shpjegojnë këtë veprim me kundërshtimin e sindikatave por gjithashtu edhe pasqyrim të pikëpamjeve të opinionit në Slloveni se se privatizimi nuk përputhej me traditën e vendit as me skemat pensionale të Evropës Perëndimore.

<sup>41</sup> Marrëveshja e Mاستrihit (protokolet e Nenit 109) kërkon që deficitet vjetore (përfshirë sigurimin social) të mos jenë mbi 3 % të BPSH-së si dhe borxhi i akumuluar të jetë nën 60 % të BPSH-së.

<sup>42</sup> Siç është përshkruar më parë, ndryshimi i kontributeve për rendin e dytë po e rritë deficitin në sistemin publik pensional në Poloni, ndërsa përpjekjet e qeverisë në Hungari për ta zbritur shterjen e të hyrave nga skema publike pensionale (e shkaktuar nga anëtarësia më e lartë se që ishte pritur e fondeve private), po e dobëson shtresën private, duke u kërcënuar fillimin e paraqitjes së garancioneve publike të shkallëve të beneficioneve private.

tanishëm. Në anën tjetër, vendet e tjera, si Sllovakia, janë duke i shqyrtuar propozimet për privatizim dhe nuk janë duke menduar si ta shtojnë moshën e pensionimit ose shkurtimin e privilegjeve të të pensionuarve. Kjo përvojë e hershme paraqet një fotografi të përzier e cila nuk i mbështet argumentet se privatizimi është është rruga e vetme e mirë për ristrukturimin e pensioneve.

Së dyti, deri më sot fokusi i reformës ka qenë relativisht i ngushtë. Përderisa ristrukturimi i beneficioneve pensionale ishte brenga më e madhe në tërë rajonin, shumë pak ndryshime kanë ndodhur në pensionet invalidore prej fillimit të periudhës tranzicionale, kur edhe u përcaktuan standarde më të shlrshme për ta ulur papunësinë e shtuar. Si rrjedhojë e kësaj, një numër i madh i pensionistëve me invaliditet me aftësi të caktuara për të punuar, por me pak shansa ose stimulime për të gjetur punë. Njësoj, edhe femrat punëtore kanë qenë të lëna mënjanë në ekonomitë e EQL-së; shumë prej tyre janë dëmtuar më shumë se të tjerët me ngritjen e moshës së pensionimit, me heqjen e elementeve për redistribucion në formulat e përfitimeve, e sidomos nga formulat e definuara të kontributeve të cilat parashohin pika-dënuese për periudhat e papunësisë në fillim të karrierës. Çështje tjetër është përfshirja më e madhe nga mbrojtja sociale për shkak të shtrirjes së punës joformale. Shumica e zyrtarëve të skemave në këto vende e pranojnë domosdonë e gjetjes së mënyrave për identifikimin e punëtorëve të papërfshirë dhe shtrirjen e mbrojtjes për t'i mbuluar edhe ata, mirëpo, ka shumë pak përpjekje konkrete në këtë drejtim. Do të ishte mirë nëse bëhen hulumtime, të cilat do ta dokumentonin gjendjen dhe do t'i identifikonin nevojat e këtyre grupeve – invalidëve, femrave të punësuar, dhe atyre të punësuar në sektorin joformal – si dhe identifikimi i mënyrave dhe përvojave më të mira në rajon, në Evropën Perëndimore e në botë, që do të shërbenin si modele për reformën. Është shumë e nevojshme që këto hulumtime të shërbejnë si katalizatorë të reformave më të gjera.

Në fund, e dhëna se ristrukturimi i pensioneve në shumë vende të rajonit po vazhdon pa consensus shoqëror, është burim për brengosje serioze. Pak kush mund të thotë se reformat mund të jenë të suksesshme në plan afatgjatë pa pranimin e tyre nga faktorët kryesorë, që ky pranim mund të merret pa ua dhënë atyre një rol përkatës në formësimin e përmbajtjes së reformës, ose se ata mund të marrin pjesë me sukses në proces pa e kuptuar qartë rolin e vet në çështjet për të cilat debatohet. Përkundër kësaj, dialogu shoqëror mbetet pika më e dobët e planifikimit të reformës pensionale në vendet e EQL-së, ndërkaq që shumë organizata të punëtorëve e aso të punëdhënësve mundohen të ndikojnë në politikën e pensionimit, por me sukses shumë të kufizuar. Aftësimi do të mund të ishte një nga masat për t'u marrë me këtë problem. Aftësimi do duhej menduar ashtu që t'u ndihmojë partnerëve socialë në formulimin e objektivave të cilët i marrin parasysht brengat imediate dhe ato afatgjata, si dhe për zhvillimin e strategjive konkrete për arritjen e këtyre objektivave. Trajnimi duhet të ofrojë poashtu rast për të mësuar nga shembujt e suksesshëm në rajon e gjetkë, për t'i analizuar aspektet teknike të financimit të pensioneve si dhe argumentet e ndryshme për dhe kundër strategjive të ndryshme reformuese, si dhe të merren informata empirike mbi efektet e reformës në vendet e EQL-së në fazat fillestare. Një aftësim i tillë mund ta forconte dukshëm dialogun shoqëror mbi reformën pensionale nëpër tërë rajonin dhe, përmes një bashkëpunimi të tillë, mund të ndihmohej që politikatat e miratuara pensionale të implementohen me sukses dhe të jenë të qëndrueshme.

### **Referencat**

Augusztinovics, Maria, "Sistemet dhe Reformat Pensionale në Vendet në Tranzicion", në *Economic Survey of Europe*, Komisioni Ekonomik për Evropë dhe Kombet e Bashkuara, 1999, VII. 3.

Njësia për Informata Ekonomike, *Country Profiles for 2000*, në [www.eiu.com/schedule](http://www.eiu.com/schedule).

Hagemejer, Krzysztof, "Transformimi i Sigurimit Social në Evropën Lindore dhe Qendrore" (versioni i parë, 1999), në Katharina Muller, Andreas Ryll, dhe Hans-Jurgen Wagener, redactorë., *Transformimi i Sigurimit Social: Pensionet në Evropën Qendrore dhe Lindore*, Heidelberg: Physica-Verlag, 1999.

Hausner, J., *Sigurimi përmes Diversitetit: Kushtet për Reformë të Suksesshme të Sistemit Pensional në Poloni*, Collegium Budapest, Instituti për Studime të Larta, Discussion Paper, Nr. 49, 1996.

*IBUS Briefing Service*, botimet 1999.

Latulippe, D., "Mosha Efektive e Pensionimit dhe Kohëzagjatja e Pensionit në Vendet e Industrializuara në mes të viteve 1950 e 1990. Çështje të Mbrojtjes Sociale, Zyra Ndërkombëtare e Punës, Discussion Paper Nr. 2, Gjenevë 1996.

Muller, Katharina, "Dhjetë vjet më vonë: Reformat e Pensioneve në EQL dhe në ish Bashkimin Sovjetik," Instituti i Frankfurtit për Studime të Transformimit, Frankfurt (Oder), shkurt 2000.

Palacios, R., M. Rutkowski, dhe X. Yu, *Reforma e Pensineve në Ekonomitë në Tranzicion*, Washington, D.C., Banka Botërore, 1999.

*Pensions International*, botimet e viteve 1999 e 2000.

Phare Consensus, *Ndryshimet dhe Zgjedhja në Mbrojtjen Sociale: Përvoja e Evropës Qendrore e Lindore*, Pantheron: Universiteti i Jorkut, 1999.

Simonovits, A., "Sistemi i Ri Pensional në Hungari dhe Problemet e tij," në Katharina Muller, Andreas Ryll, dhe Hans-Jurgen Wagener, redactorë., *Transformimi i Sigurimit Social: Pensionet në Evropën Qendrore e Lindore*, Heidelberg: Physica-Verlag, 1999.

Administrata e Sigurimit Social e SHBA-ve, *Programet e Sigurimit Social në Botë*, 1999.

**Shtojca A: Indeksat e varësisë***Grupmoshat: rinia: nën 16; të moshuarit: mbi 64; lidhur me grupin 16-64*

Zona kryesore, rajoni ose vendi	Indeksi i varësisë së të rinjve (%)					Indeksi i varësisë sp të moshuarve (%)					Gjithsejt indeksi i varësisë (%)				
	1980	2000	2010	2030	2050	1980	2000	2010	2030	2050	1980	2000	2010	2030	2050
<b>Evropa</b>	<b>33.9</b>	<b>25.8</b>	<b>22.2</b>	<b>23.1</b>	<b>24.8</b>	<b>18.9</b>	<b>21.7</b>	<b>23.6</b>	<b>36.6</b>	<b>47.5</b>	<b>52.7</b>	<b>47.5</b>	<b>45.8</b>	<b>59.7</b>	<b>72.3</b>
<i>Evropa lindore</i>	<i>33.9</i>	<i>26.4</i>	<i>21.7</i>	<i>21.8</i>	<i>23.8</i>	<i>16.1</i>	<i>18.8</i>	<i>19.4</i>	<i>31.0</i>	<i>44.1</i>	<i>50.0</i>	<i>45.2</i>	<i>41.1</i>	<i>52.8</i>	<i>67.9</i>
<i>Evropa veriore</i>	<i>33.2</i>	<i>28.6</i>	<i>25.0</i>	<i>27.4</i>	<i>27.4</i>	<i>22.7</i>	<i>23.9</i>	<i>25.5</i>	<i>38.2</i>	<i>42.7</i>	<i>55.8</i>	<i>52.5</i>	<i>50.5</i>	<i>65.5</i>	<i>70.1</i>
<i>Evropa jugore</i>	<i>37.9</i>	<i>23.1</i>	<i>21.1</i>	<i>20.5</i>	<i>24.0</i>	<i>18.0</i>	<i>24.4</i>	<i>27.4</i>	<i>41.6</i>	<i>59.7</i>	<i>55.9</i>	<i>47.5</i>	<i>48.4</i>	<i>62.1</i>	<i>83.7</i>
<i>Evropa perëndimore</i>	<i>31.0</i>	<i>25.3</i>	<i>22.6</i>	<i>24.9</i>	<i>25.5</i>	<i>22.4</i>	<i>23.6</i>	<i>26.9</i>	<i>41.6</i>	<i>47.5</i>	<i>53.4</i>	<i>49.0</i>	<i>49.5</i>	<i>66.4</i>	<i>73.0</i>
Shqipëria	60.8	45.7	36.0	31.7	30.3	8.9	9.5	11.4	20.2	29.8	69.7	55.2	47.4	51.9	60.1
Belorusia	34.5	27.6	22.3	22.5	23.5	16.2	20.1	19.7	30.6	41.8	50.7	47.7	42.0	53.1	65.3
Bosnja e Hercegovina	40.9	26.4	21.9	22.4	23.7	9.1	13.9	16.9	33.9	45.2	50.0	40.3	38.9	56.3	68.9
Bullgaria	33.5	23.9	19.2	18.3	21.7	18.0	23.4	24.1	33.7	52.0	51.5	47.4	43.4	52.0	73.7
Kroacia	31.4	25.1	23.3	23.6	24.5	17.4	21.7	24.4	35.2	44.3	48.7	46.8	47.7	58.8	68.8
Republika Çeke	37.2	23.7	18.7	18.1	21.9	21.1	19.5	21.9	37.7	60.6	58.3	43.3	40.7	55.8	82.5
Estonia	33.0	25.4	19.0	19.2	22.6	19.0	20.1	21.6	33.8	48.8	52.0	45.5	40.7	53.0	71.4
Hungaria	33.9	24.9	20.8	20.5	23.0	20.8	21.5	23.0	31.8	48.2	54.7	46.4	43.8	52.3	71.2
Letonia	30.7	26.0	19.6	21.1	23.6	19.6	21.0	23.4	33.0	44.9	50.3	47.0	43.0	54.0	68.5
Lituania	36.2	28.5	21.6	22.0	23.3	17.4	19.8	21.8	32.6	45.3	53.6	48.3	43.5	54.6	68.6
Polonia	37.0	28.3	23.1	23.4	26.7	15.4	17.5	17.7	31.8	44.8	52.4	45.8	40.8	55.2	71.5
Repub. E Moldavisë	40.8	34.8	26.8	27.1	27.5	11.8	14.7	14.6	24.3	33.7	52.6	49.5	41.4	51.4	61.2
Rumania	42.3	25.7	19.0	17.3	21.5	16.3	19.3	20.3	28.8	53.9	58.6	45.0	39.3	46.2	75.4
Federata Ruse	31.8	26.2	22.1	22.4	23.6	15.0	18.1	18.1	30.4	41.2	46.8	44.2	40.2	52.8	64.8
Slllovakia	41.2	28.6	22.5	21.8	23.3	16.4	16.5	17.0	29.6	46.0	57.6	45.0	39.5	51.4	69.3
Sllovenia	35.8	22.7	19.2	19.1	22.8	17.4	19.7	23.0	39.3	57.5	53.2	42.4	42.2	58.4	80.4
IRJ e Maqedonisë	44.5	34.3	32.1	27.8	27.0	10.7	15.2	17.6	25.9	34.7	55.1	49.4	49.7	53.7	61.7
Ukraina	32.1	26.1	21.4	21.4	23.1	17.9	20.8	22.8	32.2	45.3	50.0	46.9	44.2	53.6	68.4
Yugosllavia	36.4	30.0	27.4	26.6	27.2	14.8	19.9	21.2	29.2	37.9	51.3	49.9	48.7	55.9	65.0

*Marrë nga: Llogaritjet e OBP-së bazuar në Panoramë e Popullatës në Botë, Edicioni 1998, KB, Nju Jork 1999.*

**Shtojca B. Pjesmarrja e të moshuarve në popullatën e përgjithshme**

Zona, rajoni ose vendi	Popullata mbi 60 (% e popullatës së përgjithshme)					Popullata mbi 65 (% e popullatës së përgjithshme)					Popullata mbi 80 (% e popullatës së përgjithshme)				
	1980	2000	2010	2030	2050	1980	2000	2010	2030	2050	1980	2000	2010	2030	2050
<b>Evropa</b>	<b>16.0</b>	<b>20.3</b>	<b>22.0</b>	<b>29.8</b>	<b>34.7</b>	<b>12.3</b>	<b>14.7</b>	<b>16.2</b>	<b>22.9</b>	<b>27.6</b>	<b>2.0</b>	<b>2.9</b>	<b>4.1</b>	<b>5.7</b>	<b>9.1</b>
<i>Evropa lindore</i>	<i>14.1</i>	<i>18.7</i>	<i>19.2</i>	<i>26.4</i>	<i>34.4</i>	<i>10.8</i>	<i>13.0</i>	<i>13.7</i>	<i>20.3</i>	<i>26.3</i>	<i>1.5</i>	<i>2.0</i>	<i>3.1</i>	<i>4.1</i>	<i>6.9</i>
<i>Evropa veriore</i>	<i>19.5</i>	<i>20.6</i>	<i>23.4</i>	<i>29.8</i>	<i>31.5</i>	<i>14.5</i>	<i>15.6</i>	<i>16.9</i>	<i>23.1</i>	<i>25.1</i>	<i>2.7</i>	<i>4.0</i>	<i>4.7</i>	<i>6.6</i>	<i>9.2</i>
<i>Evropa jugore</i>	<i>15.3</i>	<i>22.0</i>	<i>24.5</i>	<i>33.6</i>	<i>38.9</i>	<i>11.5</i>	<i>16.5</i>	<i>18.4</i>	<i>25.7</i>	<i>32.5</i>	<i>1.8</i>	<i>3.4</i>	<i>5.0</i>	<i>7.0</i>	<i>11.6</i>
<i>Evropa perëndimore</i>	<i>18.2</i>	<i>21.5</i>	<i>24.0</i>	<i>32.5</i>	<i>33.9</i>	<i>14.6</i>	<i>15.9</i>	<i>18.0</i>	<i>25.0</i>	<i>27.4</i>	<i>2.8</i>	<i>3.6</i>	<i>4.8</i>	<i>6.8</i>	<i>10.7</i>
Shqipëria	7.7	9.2	10.8	18.8	24.9	5.2	6.1	7.8	13.3	18.6	0.8	0.9	1.2	2.2	5.1
Belorusia	13.7	19.2	18.9	26.0	33.5	10.7	13.6	13.9	20.0	25.3	1.9	2.0	3.2	3.9	6.9
Bosnja e Hercegovina	8.0	14.9	17.1	29.0	34.6	6.1	9.9	12.2	21.7	26.8	0.7	1.1	2.2	3.8	8.2
Bullgaria	15.7	21.3	23.6	29.2	38.4	11.9	15.9	16.8	22.2	29.9	1.6	2.2	3.6	5.3	7.6
Kroacia	14.8	20.7	22.6	28.6	33.3	11.7	14.8	16.5	22.2	26.2	1.5	1.9	3.4	5.0	7.5
Republika Çeke	16.8	18.1	22.9	30.9	40.9	13.4	13.6	15.6	24.2	33.2	1.9	2.2	3.6	6.8	9.5
Estonia	16.0	19.6	21.2	28.7	37.9	12.5	13.8	15.4	22.1	28.5	2.1	2.2	3.3	4.8	7.6
Hungaria	17.2	19.8	22.1	27.5	35.4	13.4	14.7	16.0	20.9	28.2	2.1	2.5	3.7	5.1	7.2
Letonia	16.5	20.3	21.8	28.1	35.7	13.0	14.3	16.4	21.4	26.6	2.3	2.3	3.6	4.7	7.5
Lituania	14.3	18.5	20.3	27.7	35.1	11.3	13.3	15.2	21.1	26.9	2.0	2.3	3.5	4.9	8.3
Polonia	13.2	16.4	18.3	26.0	33.4	10.1	12.0	12.6	20.5	26.1	1.5	1.9	3.0	4.5	6.8
Repub. E Moldavisë	10.8	14.2	14.6	20.9	28.5	7.7	9.8	10.3	16.1	20.9	1.0	1.3	2.1	2.8	5.0
Rumania	13.3	18.8	20.0	28.1	40.0	10.3	13.3	14.6	19.7	30.7	1.3	1.7	2.9	4.2	8.0
Federata Ruse	13.5	18.5	18.2	25.8	33.4	10.2	12.5	12.9	19.9	25.0	1.4	1.9	3.0	3.7	6.6
Slllovakia	13.4	15.4	17.5	25.6	34.7	10.4	11.4	12.2	19.5	27.2	1.5	1.8	2.8	4.1	7.0
Slllovenia	14.2	19.1	22.2	32.3	39.4	11.4	13.8	16.2	24.8	31.9	1.6	2.2	3.6	5.6	9.9
IRJ e Maqedonisë	9.2	14.6	16.4	22.6	27.7	6.9	10.1	11.7	16.9	21.5	0.8	1.2	2.1	3.4	5.8
Ukraina	15.5	21.0	21.2	27.2	35.1	11.9	14.1	15.8	20.9	26.9	1.7	2.3	3.6	4.5	7.3
Yugosllavia	12.5	18.6	19.8	24.7	29.6	9.8	13.3	14.3	18.7	23.0	1.3	1.4	2.8	4.0	6.1

Marrë nga: Llogaritjet e OBP-së bazuar në Panoramë e Popullatës në Botë, Botimi 1998, KB, Nju Jork 1999.

